



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës  
Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 27.03. 2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, , Fatmir Xhelili, Muharrem Nitaj, Xhelal Sveçla, Ismet Beqiri, Fadil Beka, anëtarë.

**Munguan:** Haxhi Shala, Zoran Mojsilović, Drita Millaku, Ramiz Kelmendi, Bahrim Shabani

**Deputetët të tjerë, pjesëmarrës në takim:** Shemsi Syla

**Përfaqësuesit nga Policia e Kosovës-** Shpend Maxhuni-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Riza Shillova- Drejtor i Departamentit për Hetime, Rashit Qalaj- Departamenti i Operacioneve-Policia e Kosovës.

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

**Mbledhjen e kryesoi,** Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e komisionit të mbajtura me datë 06.02.2018, 07.02.2018 dhe 21.02.2018;
3. Raportimi i Drejtorit të Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z.Shpend Maxhuni për raportin vjetor të punës për vitin 2017;
4. Të ndryshme.

*Kryesuesi i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

**1. Miratimi i rendit të ditës.**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

**2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e komisionit të mbajtura me datë 06.02.2018, 07.02.2018 dhe 21.02.2018.**

*Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.*

**3. Raportimi i Drejtorit të Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z.Shpend Maxhuni për raportin vjetor të punës për vitin 2017.**

**Kryesuesi**, fillimisht theksoi se për këtë takim është ftuar z.Shpend Maxhuni-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës për të prezantuar raportin vjetor të punës për vitin 2017 dhe fjalën ia kaloi z.Maxhuni.

**Shpend Maxhuni-Drejtori Përgjithshëm i Policisë së Kosovës**, fillimisht theksoi se falë një bashkëpunimi të ngushtë mes qytetarëve të Kosovës, institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, policia ka arritur që të ketë rezultate konkrete në të gjitha aspektet. Gjatë periudhës raportuese, Policia e Kosovës ka evidentuar gjithsej 49214 raste, prej të cilave 35021 janë klasifikuar si vepra penale, ndërsa 14193 raste janë klasifikuar si kundërvajtjeve dhe raste të natyrave tjera. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016, numri i rasteve ka shënuar rënie për 3.55%, numri i veprave penale po ashtu ka shënuar rënie për 1.25%, si dhe rënie për 8.79% e numrit të kundërvajtjeve dhe raste të natyrave tjera.

Tutje theksoi e falë angazhimit të policisë, ka pasur rënie të veprave penale siç janë numri i lëndimeve të rënda trupore ka shënuar rënie për 4.15%, numri i vjedhjeve ka shënuar rënie për 6.06%, numri i vjedhjeve të rënda ka shënuar rënie për 6.76%, ndërsa pavarësisht angazhimit me masat preventive, strategjive nacionale numri i vrasjeve ka një rritje të lehtë për 3.84% ndërsa edhe numri i grabitjeve ka një rritje për 3.94%. Policia e Kosovës ka ndaluar 3170 persona për shkak të dyshimeve në përfshirje në akte kriminale, ku në raport me periudhën e njëjtë të vitit

2016 është shënuar një rënie për 8.46%. Po ashtu Policia e Kosovës ka arrestuar 15608 persona, të cilët në bashkëpunim me autoritetet përkatëse janë dërguar në procedura të mëtejme. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet një ngritje e personave të arrestuar për 10.75%.

Në kuadër të operacioneve të saj policia ka konfiskuar 1211 armë zjarri të llojeve të ndryshme dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2016 është shënuar një rënie për 6.26%, si dhe ka konfiskuar 26178 copë të municionit të kalibrave të ndryshme dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2016 është shënuar një ngritje për 1.38%. Gjithashtu policia ka qenë e angazhuar edhe në menaxhimin e protestave dhe tubimeve gjithsej 186 protesta të ndryshme ku janë angazhuar. Në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2016 vërehet një ulje e protestave dhe tubimeve për 25.89%. Gjithashtu edhe njësia Speciale Intervenuese ka qenë e angazhuar në 161 aktivitete policore me rrezikshmëri të lartë. Në rrafshin e sigurisë publike, siguri a në trafikun rrugor ka qenë prioritet ku janë hartuar plane, strategji duke u koordinuar me institucionet e tjera.

Brenda kësaj periudhe janë hartuar 62 raporte analitike, të cilat kanë qenë të orientuara në identifikimin dhe adresimin e dukurive negative në trafikun rrugor, duke përfshirë fenomenologjinë dhe etiologjinë e aksidenteve, janë hartuar 103 raporte shkresa në lidhje me gjendjen e infrastrukturës rrugore, të cilat janë adresuar tek institucione përkatëse, janë realizuar 79 takime dhe pjesëmarrje në 70 emisione televizive, të cilat kanë qenë të fokusuara në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor, 28 fushata për vetëdijesimin e pjesëmarrësve në trafikun rrugor, 62 ligjërata në shkolla për vetëdijesimin e nxënësve, si dhe pjesëmarrja në 13 konferenca, simpoziume, ekspozita vendore dhe ndërkombëtare në fushën e sigurisë në trafikun rrugor. Gjithashtu theksoi se për këtë çështje është formuar task forca me qëllim të parandalimit të aksidenteve të trafikut rrugor, ku janë shqiptuar 397638 tiketa për kundërvajtje në trafikun rrugor, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, tregon një ngritje të shqiptimit të tiketave për 21.49%, aksidenteve në trafikun rrugor ka pasur apo rënie për 4.09%, aksidentet me pasoja fatale fatkeqësisht kanë shënuar ngritje për 23.23%, ndërsa sa i përket aksidenteve me lëndime ka pasur ngritje për 5.29%.

Tutje theksoi se policia në kuadër të konceptit policia në bashkësi, ka realizuar një sërë aktivitete për problematikën në bashkësi, me qëllim të përafrimit me të gjitha komunitetet Për këtë qëllim janë lansuar një sërë projektesh për të ndihmuar qytetarin, për të ngritur vetëdijen tek qytetarët. Në kuadër të angazhimeve të reja, siç është aspekti i trafikimit me qenie njerëzore, pengimin e tregtimit të narkotikëve, theksoi se vazhdojnë të kenë operacione dhe plane konkrete.

Në fushën e luftimit të trafikimit me qenie njerëzore, gjatë kësaj periudhe janë punuar në 159 raste, prej tyre 130 raste kanë qenë të reja. Janë realizuar 42 plane operative, 100 operacione, neutralizuar 3 grupe kriminale, janë arrestuar 203 persona të dyshuar, janë ngritur 82 kallëzime penale, 24 raste janë dorëzuar në prokurori me raport të veçantë, 38 raste janë dorëzuar në gjykatë-divizioni për kundërvajtje, ndërsa për 15 raste vazhdojnë hetimet. Brenda kësaj periudhe janë identifikuar 32 viktima të trafikimit, ku prej tyre 25 janë asistuar duke u strehuar në strehimoret përkatëse për riintegrim dhe rehabilitim ndërsa të tjerat janë kthyer në familje.

Në fushën e parandalimit, hetimit dhe zbulimit të trafikimit me narkotikë janë punuar në 1423 raste, prej tyre

1368 raste kanë qenë të reja. Janë realizuar 788 operacione, neutralizuar 17 grupe kriminale, hetuar 1732 persona të dyshuar, arrestuar 1426 persona, ngritur 1022 kallëzime penale

ndaj 1358 personave. Janë konfiskuar: 391.3 gramë heroinë 713.05 gramë kokainë 147.74 gramë ekstazi 1908 kg. 176.75 gramë marihuanë, 5898 bimë kanabis, 155.05 gramë fara kanabis.

**Kryesuesi, Drejtori Përgjithshëm i Policisë së Kosovës** propozoi që përveç leximit të raportit nga ana e Drejtor të Përgjithshëm të Policisë, të jepet një hapësirë edhe për çështje tjera, duke mos përjashtuar edhe tre mujorin e vitit 2018.

**Shpend Maxhuni, Drejtori Përgjithshëm i Policisë së Kosovës** tutje theksoi se duhet ti lëvdohemi punës së Policisë së Kosovës për sukseset dhe rezultatet e arritura. Gjithashtu theksoi se ulja e trendëve të dukurive negative është pozitive, duke shtuar që aksidentet e trafikut kanë qenë dukuria më e rëndë, ku kanë pësuar shumë jetë njerëzish. Po ashtu theksoi se përgjatë 2017 është bërë analiza që i referohet të gjitha llojeve të krimeve për kokë banori dhe në të gjitha trendët e dalura shihet që kosova qëndron mirë në raport me rajonin dhe më gjerë.

**Muharrem Nitaj**, lidhur me raportin e prezantuar, shtroi pyetjen si në vijim. Sa ka qenë Policia e Kosovës pjesë e veprave të cilat janë në kundërshtim me ligjin? A ka të dhëna që sa pjesëtar të policisë kanë qenë të përfshirë në vepra kriminale?

**Shpend Maxhuni, Drejtori Përgjithshëm i Policisë së Kosovës** lidhur me këtë pyetje, theksoi se sipas ligjit, të gjitha ankesat që adresohen për zyrtarët policor, ato menaxhohen nga Inspektorati Policor i Kosovës.

**Kryesuesi**, njoftoi që Komisioni ka formuar grupin punues për mbikëqyrjen e ligjit të IPK-së, ku gjatë procesit janë para disa shkelje nga ana e zyrtarëve policor, siç ka qenë përfshirja në një rrahje. Tutje theksoi se ka disa pyetje për Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë. A besoni se janë marrë masat e nevojshme, në kuadër të kompetencave si menaxhment i Policisë së Kosovës ndaj vartësve, të cilët janë të dyshuar për vepra penale? A është menduar që nga ana e menaxhmentit të sigurohet jeta e policëve? Duke shtuar që sigurimi jetësor dhe shëndetësor është një problematikë që vazhdon të përcillet nga viti në vit. Ndërsa duke iu referuar aksionit të djeshëm në veri të vendit, ku është arrestuar Marko Gjuriq, për çka ka qenë i akuzuar? Pasi aksioni i policisë pasoi vetëm me pesëmbëdhjetë minuta ndalesë në stacionin e policisë dhe u lirua. Për këtë arsye kërkoi, që zyrtarisht do të ishte mirë të sqarohet se për çka ka qenë i akuzuar dhe arsyeja e lirimit? Për këtë arsye kërkoi që nëse është e mundur që nga ana e z.Maxhuni të jepet sqarim për këtë, pa e lënduar procesin.

**Fatmir Xhelili**, duke iu referuar raportit të Policisë së Kosovës, theksoi se rezultatet janë të dukshme, të cilat i vlerëson Komisioni. Tutje theksoi se në kuadër të obligimeve për procesin e integriteteve evropiane, është luftimi i korrupsionit dhe kriminimit të organizuar. Tutje shtroi pyetjet: Sa janë kapacitetet e policisë për këtë periudhë kohore të gatshme, për të luftuar këto kategori të kriminimit? A janë ekipet e përgatitura dhe a ka nevojë për trajnime dhe ekspertiza shtesë? Cili është relacioni mes prokurorisë dhe gjyqësisë, që trekëndëshi Polici, prokurori dhe gjyqësi të kenë bashkëpunim? A mendoni që rritja e gjobave në ligjin për kundërvajtje nuk është e mjaftueshme, në mënyrë që të ndikonte në uljen e rasteve dhe viktimave në trafikun rrugor? A janë ndërmarr masa të tjera për të zvogëluar humbjet e jetrave në trafik?

**Xhelal Sveçla**, fillimisht përgëzoi zyrtarët e Policisë së Kosovës për aksionin e djeshëm të arrestimit të Marko Gjuriq, duke shtuar që aspekt mjaft i rëndësishëm është edhe kontrolli i brendshëm i policisë. Duke iu referuar të dhënave të paraqitura në raport, shtroi pyetjet si në vijim: Sa është e gatshme Policia e Kosovës të ndërtoj dhe mbroj integritetin e zyrtarit policor dhe policisë në përgjithësi? Sa është e fuqishme policia për luftimin dhe parandalimin e konfliktit të interesit tek secili pjesëtar i policisë?

**Ismet Beqiri**, duke iu referuar raportit vjetor të Policës së Kosovës, theksoi se përkundër mangësive që janë evidente dhe që janë njerëzore, duke shtuar që është obligim i policisë që të luftojnë këto dukuri negative. Gjithashtu theksoi se Policia e Kosovës vazhdon të jetë institucioni më i besueshëm, shtoi se sa i përket kushteve të punës, sigurimin shëndetësor, duhet të bëhet më shumë, me qëllim të kryerjes së punës sa më mirë.

Tutje shtroi pyetjen si në vijim. Në çfarë niveli është bashkëpunimi me INTERPOL dhe EUROPOL, duke qenë se Kosova nuk është pjesë e këtyre mekanizmave? Operacionin e realizuar me rastin e arrestimit të Marko Gjuriq, e vlerësoi se zbatim të ligjit, duke qenë se ka hyrë në territorin e Kosovës pa leje adekuate, gjithashtu theksoi se Policia e Kosovës duhet të jetë e pavarur politikisht duke mos u ndikuar nga asnjë parti politike.

**Shemsi Sylja**, shtroi pyetjet si në vijim për Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë. Sa kriminel lufte janë arrestuar ose janë në plan të arrestohen? A është e vërtetë që nga ana e Komandantit të Policisë së Kosovës në Veri, është refuzuar urdhri për kryerjen e aksionit për arrestimin e Marko Gjuriq-it?

**Kryesuesi**, shtroi pyetjen si në vijim. A ka pasur akuza të tjera ndaj Gjuriq?

**Shpend Maxhuni, Drejtori Përgjithshëm i Policisë së Kosovës** lidhur me pyetjet e ngritura nga deputetët, theksoi se Policia e Kosovës shquhet për vetëkritik për çfarëdo dukurie brenda policisë, Gjithashtu theksoi se dëshiron të siguron që të gjitha strukturat policore që bien ndesh me ligjin, iniciohen procedurat ligjore përkatëse për një situatë. Tutje theksoi se sa i përket disiplinës së brendshme, theksoi se përgjegjësitë janë të ndara sipas ligjit dhe është Inspektorati Policor i Kosovës që ka kompetencë për të hetuar policinë, në rastet kur dyshohet se prestatët e policisë kanë shkelur ligjin. Mund të jetë çështje perceptimi që nuk është vepruar si duhet në rrethana të caktuara, por Policia e Kosovës është e hapur për të dhënë informacionet e nevojshme për këtë çështje. Tutje theksoi se policisë së Kosovës i mungon sigurimi shëndetësor për pjesëtarët e saj, duke shtuar që pas punës që është duke u bërë nga institucionet kompetente të rregullohet edhe kjo çështje për policinë e Kosovës.

Ndërsa sa i përket veprimit ligjor të Policisë së Kosovës me rastin e arrestimit të z.Marko Gjuriq, theksoi se kanë pasur vendimin e Qeverisë së Kosovës për të ndaluar hyrjen e zyrtarëve të shtetit serb që kanë paralajmëruar, që do të vizitojnë Kosovën, duke shtuar që veprimi operacional është kryer nga njësitet kompetente. Ndërsa sa i përket pyetjes së z.Selimi, theksoi se z.Gjuriq ka pasur ndalesë për hyrjen në Kosovë por jo ndonjë kuze tjetër.

Ndërsa në përgjigjeje të pyetjeve të z.Fatmir Xhelili, theksoi Policia e Kosovës i ka të gjitha kapacitetet e nevojshme për të luftuar krimin e organizuar dhe janë zhvilluar kuadro të kësaj lëmie brenda dhe jashtë Kosovës, duke shtuar që janë të përkushtuar bashkë me institucionet e tjera për të dhënë kontributin e tyre si ën procesin e integritetit në BE por edhe për përmbushjen e misionit të policisë. Gjithashtu theksoi se janë në bashkëpunim me Prokurorin e shtetit ku kanë

identifikuar një numër të rasteve të profilizuara dhe bashkëpunimi është i mirë dhe ka avancuar kohëve të fundit, duke shtuar që prokuror dhe hetues policor bashkëpunojnë. Ndërsa sa i përket bashkëpunimit me gjykatat theksoi se ky bashkëpunim është me prokurorinë dhe se vendimet e gjykatës nuk komentohen dhe zbatohen nga ana e policisë. Ndërsa sa i përket humbjeve të jetrave në trafik, theksoi se nga ana e policisë janë bërë përpjekje, ku përveç ligjit për trafikun janë bërë edhe plane konkrete dhe ka një trend të uljes së trafikut me fatalitet. Ndërsa sa i përket kontrollit të brendshëm, theksoi se janë njësitë e specializuara që merren me këtë aspekt, siç është Njësia e Standardeve Profesionale si dhe mekanizma të tjerë menaxheria që kontribuon në kontrollin e brendshëm. Ndërsa sa i përket pyetjes për mbrojtjen e integritetit, theksoi se si polici me menaxhmentin dhe strukturat e saj, ka dëshmuar që është e gatshme të mbroj integritetin e saj, duke shtuar që rrethanat individuale nuk duhet ndikuar në perceptimin për institucionin. Duke shtuar që janë bërë vlerësime pozitive edhe nga mekanizma ndërkombëtar ku për periudhën 2011-2015, është vlerësuar që Policia e Kosovës është profesionale dhe e besueshme dhe më pak ndikuar politikisht dhe më pak e korruptuar. Ndërsa sa i përket konfliktit të interesit, theksoi se edhe ky aspekt është i paraparë në planin e integritetit dhe kurdo që në vlerësimet e policisë identifikohet ndonjë veprim që është konflikt interesi ndërmerren masa për të shmangur dhe se nuk ka shqetësim të përmasave të tilla. Pavarësisht që Kosova nuk është pjesë e INTERPOL-it, policia ka bashkëpunim dhe jo vetëm me këtë mekanizëm, por edhe me EUROPOL dhe mekanizma të tjerë. Sa i përket INTERPOL-it theksoi se qasja është përmes prezencës ndërkombëtare që është në Kosovë. Gjithashtu theksoi se duke qenë se Kosova është pjesë e koalicionit global në luftë kundër ISIS, shtoi se policia është aktive për këtë çështje. Ndërsa sa i përket menaxhimit të integruar të kufijve, theksoi se sa i përket pjesës veriore është po ai proces që aplikohet edhe në pjesë të tjera të kufijve të vendit dhe shtoi se nuk kanë ndonjë problem në këtë fushë. Ndërsa sa i përket krimeve të luftës, shtoi se këto krime akoma nuk janë përgjegjësi e institucioneve të Kosovës, ndërsa janë disa raste në hetim e sipër pro për shkak të ndjeshmërisë nuk mund të flitet më shumë për to. Gjithashtu shtoi se Policia e Kosovës është e angazhuar dhe serioze që për çfarëdo individ që është i dyshimtë për krime të luftës do të ndërmerren masa. Po ashtu theksoi se deklaracioni me përgjegjësi që nuk ka pasur refuzim nga Komandanti i Stacionit Policor në veri dhe kanë zbatuar të gjitha urdhrat.

**Xhelal Sveçla**, shtroi pyetje për z.Maxhuni. Nga 7500 zyrtar policor që janë aktivë, sa prej tyre janë arrestuar dy herë, duke qenë pjesëtar të policisë ose para se të jenë zyrtar policor? Nëse ka raste, mund të jepen këto të dhëna në formë të raportit për Komisioni?

**Shpend Maxhuni, Drejtori Përgjithshëm i Policisë së Kosovës** theksoi se në këtë takim nuk posedon këto të dhëna, pro do të ofrohen tek Komisioni. Ndërsa theksoi se përgjatë procesit të përzgjedhjes për zyrtar policor, i nënshtrohen një sërë procesesh selektive dhe nëse ka ndonjë të kaluar kriminale nuk mund të bëhet pjesëtar i policisë. Ndërsa, nëse ndodhe pasi të jetë pjesë e policisë, atëherë ndërmerren masat adekuate.

**Kryesuesi**, falënderoi Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, z.Maxhuni, për raportimin për raportin e viti 2017.

**Shpend Maxhuni, Drejtori Përgjithshëm i Policisë së Kosovës** gjithashtu falënderoi Komisionin duke kërkuar mbështetjen e tyre për të proceduar tutej Projektligjin për pensionimin pjesëtarëve të Policisë së Kosovës.

**Kryesuesi**, deklaroi në emër të Komisionit që, pasi të procedohet nga Qeveria për ën Kuvend, projektligji do të ketë mbështetjen dhe do të procedohet tutje. Gjithashtu theksoi se edhe aksioni i djeshëm( arrestimi i Marko Gjuriq) është mbështetur nga Komisioni.

#### **4. Të ndryshme.**

Nuk pati çështje për tu diskutuar.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

---

**Haxhi Shala**